




Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komiteti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

12	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	21.02.2019, në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Arlinda Kurtaj, Udhëheqëse e Sektorit për punë administrative të KK-së, punë të përbashkëta dhe çështje teknike
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Haki Podrimaj, Ardita Idrizaj, Eliot Kukiqi dhe Ajshe Metaj.
Mungojnë:	Besa Ferati
Pjesëmarrës të tjerë:	Kryetari Haki Rugova, Edona Bujupi-Loxha, Besart Dreshaj, Demë Çeta, Lulzm Shoshi, Hysni Maxharraj, Hajrush Shoshi, Lulzim Blakaj, Mujë Osmanaj, Enver Rugova, Hysen Pelaj OSBE, Naser Hashimi, Jashar Blakaj dhe Vjosa Hysenaj.
Rendi i ditës: 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba; 3. Shpallja në diskutim publik për plotësim-ndryshim të rregullores për ndarjen e bursave dhe 4. Shpallja në diskutim publik e projekt-rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor për fëmijët dhe 5. Shqyrtimi dhe miratimi i kalendarit të takimeve për mbledhjet e KPF-së dhe KK-së për vitin 2019.	
Diskutimet:	
Kryesuesi z.Qaush Balaj, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje, propozoj që rendit të ditës t'i shtohet edhe pika e pestë, shqyrtimi dhe miratimi i kalendarit të takimeve për mbledhjet e KPF-së dhe KK-së për vitin 2019. Pyeti kush është që të miratohet rendi ditës me pikën e pestë dhe konstatoj se rendi i ditës miratohet një zërit, pa vërejtje.	

Fjalën e ka kërkuar Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj, përshëndeti të pranishmit. Në kuadër të Planit Zhvillimor kemi mbajtur një takim dhe ka qenë efektiv, kanë dalë ide dhe projekte që janë në të mirë të grave dhe rinisë, kemi qenë prezent: gratë asambleiste, gra nga komuna dhe në kuadër të këtij plani në kemi debatuar dhe kemi ardhur në përfundim që disa projekte duhet të realizohen në të ardhmen dhe kërkoj të futen si rend dite dhe t'i debatojmë në Kuvend, nuk do të thotë këto projekte të realizohen menjëherë vetëm do t'i propozojmë pastaj përmes USAID-it apo komunës të realizohen, kërkoj të hyjë edhe kjo si pikë e rendit të ditës në KPF dhe pastaj të kaloj në Kuvend dhe unë do të përmbledh e pastaj vendosim në Kuvend.

Kryetari - Përshëndeti të pranishmit. Adresimi nuk është i saktë, disa elemente që ju i keni kërkuar këtu nuk mund të hynë në planin zhvillimor, karakteri i planit zhvillimor më shumë është orientues dhe i ka kornizat e veta dhe vlen për një periudhë të ardhshme, komuna ka edhe dokumente tjera dhe strategji. Në strategji këto mund të listohen si projekte edhe ju mund ta keni strategjinë komunale, që është punuar nga grupi i ekspertëve, prej planit zhvillimor dhe strategjisë projektet e listuara që janë, ato mund të hynë në planifikime buxhetore, kur jepen propozimet për buxhet nga drejtoritë përkatëse, mund të hapen këto tema edhe më saktë.

Ajshe Metaj - Takimet me USAID-in kanë qenë edhe përpara dhe janë mbajtur në kuadër të qeverisjes së mirë, më një theks të veçantë për gratë dhe rininë, këto projekte që ne i kemi listuar nuk i adresojmë vetëm komunës, se i dimë kapacitetet e komunës mirëpo edhe komuna është e obliguar aq sa ka mundësi, unë nuk po shohë problem këtu të futet në rend dite dhe pse mos të behët debat për këto projekte, të dimë sa ka kapacitet për të na ndihmuar, sa ka kapacitet nga jashtë? kjo është në të mirë të qytetarëve dhe nuk po shohë diçka problem.

Naser Hashimi - USAID, unë nuk po shohë problem pse mos të futën në plan zhvillimor, pse të mos i jepet mundësia grupit të grave ti elaburojnë këto propozime.

Kryesuesi - I ndëruar Naser, ne nuk i mohojmë dhe nuk mendojmë se janë të panevojshme ato projekte, mirëpo është çështje e proceduarve, nëse është që të futet në plan zhvillimor atëherë i futim kur është pika e rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i planit zhvillimor, ato të cilat nuk i takojnë këtij plani e tha edhe Kryetari është në vija të trasha, ato që janë projekte që mund të futen në listën e projekteve kapitale do të kemi pikën e rendit të ditës, hartimin e buxhetit, nuk e kam të qartë së çfarë të futim këtë pikë të rendit të ditës.

Lulzim Shoshi - Nëse keni propozime konkrete unë mendoj se ato nuk kanë nevojë të debatohen në Kuvend por të hynë në planin zhvillimor për periudhën e ardhshme, pse mos të përfshihen ato që u thanë në plan zhvillimor ose strategji për vitet e ardhshme por pa pasur nevojë të diskutohen në Kuvend.

Besart Dreshaj - Kërkesat e juaja nuk mund të bëhen pjesë e planit zhvillimor, për arsyes së aty nuk shënon projektet kapitale por është një hartë orientuese se si do të orientohet komuna jonë. Kërkesa e Ajshës është nga grupi joformal dhe kërkesat e tyre mundem me i cek në Kuvend në pika të ndryshme dhe të bisedojnë por nuk mund të hynë në plan.

Ajshe Metaj - Hartohet strategjia dhe nuk do të thotë ato të realizohen nesër por vetëm të jenë aty të cekura, pastaj mund të kontriboj komuna ose donator të tjerë vetëm të jenë aty.

Haki Podrimaj - Përshëndeti të pranishmit, muajin e ardhshëm vjen plani zhvillimor dhe do të debatojmë në Kuvend, po e debatojmë në atë pikë të rendit të ditës dhe vendosim.

Kryesuesi - Gjithçka në rregull por për këtë takim nuk mund të jetë pikë e rendit të ditës, i kemi dy mundësi: nëse ka nevojë më futë ndonjë pikë në mbledhjen e KPF-së dhe KK-së, në këto dy takime mund t'i debatojmë se bashku me propozimet nga tereni që janë marrë nga debatet, e dyta nëse ka diçka ndonjë projekt të veçantë atëherë e futim kur debatohet për kornizën buxhetore dhe në rastin kur e kemi shqyrtimin e projekteve për vitin e ardhshëm.

Kryetari - Këtë material nuk e ka pasur askush, derisa ju keni nxjerr këtë konstatim nuk kanë qenë të përfaqësuar mjaftueshëm në procesin e hartimit të planit zhvillimor. Planin zhvillimor nuk është hartuar ende, aty e ka mor një kompani profesionale më tender për të hartuar në vitin e kaluar, ne e kemi në teren pse mos me debatim, ne nuk kemi nevojë të dërgojmë në Kuvend këtë, por grupi jo formal mundeni të mblidheni dhe të debatonin dhe ju mbani të drejtën edhe në Kuvend me i prezantim por tani ju si asamblistë e prezantoni.

Naser Hashimi - Ideja ishte që anëtarët e KPF-së, të njoftohen dhe asgjë më shumë.

Kryesuesi - Ju kërkuat pikë të rendit të ditës dhe jo njoftim, kjo është diçka tjetër dhe askush nuk e mohon këtë.

Kryetari - Unë nuk e kam tendencën të bllokojë këtë dhe aq më pak kur këto ide vijnë nga ju gratë, unë jam i gatshëm në çdo moment të mblidhemi e debatojmë dhe ftoni edhe gratë tjera këtu dhe ju mund të propozoni projekte, mamogrami nuk mund të jetë në plan zhvillimor por duhet të shënohet në formë tjera, në vijë të trasha, duhet të trajtohen ligjërisht dhe në plan zhvillimor nuk ka gjini, ne kemi obligim të ju bëjmë ftesë ju që të merrni pjesë në hartimin e planit zhvillimor, nëse kjo shkon në KK atëherë çfarë vendimi të merret në Kuvend? Mos të keqkuptohemi, unë nuk dua të fus diçka në dokumente komunale dhe të mbet aty, ne kemi obligim dhe ju bëjë ftesë të jeni aktiv në hartimin e strategjisë të dokumenteve të ndryshme.

Ajshe Metaj - Kjo ishte dhe nuk di si të ja vijë emrin se ne tani punojmë bashkë e përcjellim, e di se komuna nuk e ka kapacitetin të bëjë këto projekte që i kemi në letër por janë propozime që të futen në kuadër të planit, nuk është për periudhë të caktuar dhe ne nuk po kërkojmë asgjë për vete.

Kryetari - Unë jam më shumë që të mblidhemi dhe të debatojmë dhe pastaj shikojmë për këto projekte, një të drejtë që e keni, shfrytëzoni dhe mos e kërko atë që ju veç se e keni, realisht pika që ti kërkoje veç se u konsumua, mbeti që të thirret një mbledhje dhe të debatojmë lidhur më këto projekte dhe vetëm më njoftoni unë do të jem me stafin tim aty dhe pse sa e pashë unë këtij dokumenti nuk ka çka t'i shtohet.

Kryesuesi - Kush është që rendit i ditës së bashku më prezantimin që dhashë më një pikë shtesë të

aprovohet?	
Vendimet:	
Miratohet njëzëri rendi i ditës më propozimin: Shqyrtimi dhe miratimi i kalendarit të takimeve për mbledhjet e KPF-së dhe KK-së për vitin 2019 dhe i njëjti i kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 1.	
Diskutimet:	
Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës, Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. Pyet nëse dikush ka ndonjë pyetje apo diskutim rreth procesverbalit? Nuk ka kërkuar fjalën askush.	
Vendimet:	
Miratohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.	
Personat përgjegjës për zbatim:	
Afati për zbatim:	
Shqyrtimi i pikës 2.	
Diskutimet:	
Kryesuesi - Vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba, kjo rregullore ka kaluar nëpër procedurat e nevojshme, ka qenë në KPF, KK dhe është mbajtur dëgjimi publik, fjalën ja kaloj Kryetarit. Kryetari - Fjalën ja kaloj Hysni Maxharrit. Hysni Maxharri - Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa përshëndeti të pranishmit. Kjo rregullore ka kaluar edhe në dëgjim publik dhe qytetarët nuk kanë dhënë ndonjë propozim më shumë kanë dalë më pyetje jashtë teme dhe nuk mund të them se ka ndonjë propozim nga dëgjimi. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktohen të gjitha të hyrat komunale duke përfshirë taksat, ngarkesat dhe gjobat të cilat do të merren nga drejtoritë komunale, këto me ngjyrë të kuqe janë të propozuara të largohen ndërsa më ngjyrë të verdhë janë të propozuara të shtohen në rregullore. Kryesuesi - Fjalën ja kaloj Haki Podrimajt. Haki Podrimaj - Unë e kam një propozim të Drejtoria e Inspektionit, propozoj një pagesë 5 euro për çdo therje të licencuar, arsyeja është se veterinari jonë shkon atje dhe e bënë verifikimin dhe ka shpenzime, ndërsa 5 euro nuk është taksë e madhe. Kryetari - Duhet të shikojmë të kompetencat, është kompetencë e jona marrja e kësaj pagese, fjalën ja kaloj Demë Çetës. Demë Çeta - Mendoj se është e qëlluar meqenëse AVUK – ut nuk i paguajnë edhe pse ne i kemi disa kompetenca të ngatërruara, meqenëse nuk paguajnë për ata të paguajnë për ne këtë taksë.	

Fletëpagesa merret tek ne dhe paratë na kalojnë në xhirollogari.

Zenel Shatri - Unë deshta të pyes ligjshmërisht se a është në rregull, vërja e kësaj takse? Kush mund ta sqarojë këtë në mënyrë ligjore, a keni njohuri?

Kryetari - Çështja e inspeksionit është pak histori, ka qenë komunal pastaj i kanë marrë këto kompetenca, nëse ju kujtohet një periudhë kohore edhe e kemi bërë Drejtorinë e Inspeksionit edhe e kemi hjekë, punët që është dashur me i bere AVUK-u i ka bërë inspektori jonë dhe është paguar nga ne, te taksa mendoj së nuk ka lidhje në kompetencë të kujt është, nëse kemi të drejtë ne si komunë me vjelë atë taksë, kjo është njëjtë sikur policia që nuk është në kompetencë tonë por denimet në komunikacion shkojnë në buxhet tonë, komunës i vijnë si e hyre komunale edhe pse në komunë në rregullore nuk e kemi.

Lulzim Blakaj - Të gjitha këto thertore licencohen nga niveli qendror. Nga niveli qendror shkojnë edhe tarifat në kuadër të shërbimeve që kryejnë ata, ne si komunë kemi drejtë por i kemi hjekë me i ngarkuar me tarifa sikur bizneset, por atë e kemi hjekë dhe të gjitha bizneset janë të liruara nga taksat.

Kryetari - Unë e kisha thënë kështu, propozimi ti shkojë kuvendit dhe shkon në ministri, nëse është ligjore e marim këtë nëse jo e kthejnë.

Haki Podrimaj - Deri në mbledhjen e Kuvendit ne i shikojmë edhe komunat tjera, nëse janë duke e vjelë këtë taksë edhe komunat tjera e kalojmë në Kuvend.

Hysni Maxharri - Propozojë të jetë rekomandim i KPF-së deri në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit ne kërkojmë interpretimin e Zyrës ligjore dhe e prezantojmë këtë pasi marrim përgjigjen e Zyrës ligjore.

Eliot Kukiqi - Kam pyetje për lidhjen e martesës jashtë orarit të punës?

Hysni Maxharri - Po kjo bëhet më kërkesën e personave të caktuar që të lidhin kërkesë jashtë orarit të punës dhe paguhet 50 euro, rastet e dasmave që lidhin kurore aty për aty

Kryesuesi - Pasi që diskutime tjera nuk ka, pyes anëtarët e komitetit kush është që kjo rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba t'i rekomandohet Kuvendit për miratim.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime të tjera, KPF njëzëri rekomandon: Projekt-Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba t' i kalohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi - Po vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik për

plotësim-ndryshim të rregullores për ndarjen e bursave, fjalën ja kaloj Kryetarit.

Kryetari - Sa i përket ndarjes së bursave nuk kam disponim të flas, vetëm kam disponim që gjithmonë të ndahen bursat, sa më shumë që është e mundur. Kuvendi aq shumë e kanë komplikuar këtë punë, herë i ka mar kompetencat, janë ankuar se nuk jem duke i ndarë mirë ne, kur i moren ata përsipër edhe me keq, vetëm diçka dijnë se, nuk jemi duke i ndarë mirë dhe as nuk kam ndërhyrë në përcjellje, asnjëherë nuk kam ndërhyrë në proces, komisionet kanë qenë dhe ato komisione i kanë ndarë si kanë dëshirë, e di që komisionet i kanë ndarë në atë formë që një anëtar komisioni ka pasur dikë, tjetri anëtar dikë dhe janë pajtuar se edhe pse të partive të ndryshme kur kanë interesa të përbashkëta pajtohen mirë, kjo rregullore u nderru që katër here. Fjalën ja kaloj Hajrush Shoshit.

Hajrush Shoshi - Përshëndeti të pranishmit, këtë rregullore e keni marrë, komisioni ka punuar dhe i keni ndryshimet.

Kryesuesi - Nëse nuk keni diçka, kush është që kjo të kalojë në Kuvend? Me 6 vota për, KPF-ja i rekomandon kuvendit komunal shpalljen në diskutim publik draft-rregulloren për ndarjen e bursave.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF njëzëri rekomandon: Plotësim-ndryshimi i Rregullores për ndarjen e bursave t'i kalohet KK-së për shqyrtim dhe shpallje në diskutim publik.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Diskutimet:

Kryesuesi - Po vazhdojmë më pikën e katërt e rendit të ditës, shpallja në diskutim publik e projekt-rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor për fëmijët, lidhur më këtë draft-rregullore, e kemi anëtarin e komisionit që ka punuar, Muhamet Gusturani.

Muhamet Gusturani - Përshëndeti të pranishmit. Jam anëtar i komisionit për hartimin e kësaj rregullore, përndryshe baza e kësaj rregullore vjen nga Konventa evropiane për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, më tutje prezantoj këtë draft-rregullore komunale.

Kryesuesi - Anëtarët e komitetit nëse dëshiron dikush fjalën? Ajshe Metaj ka kërkuar fjalën.

Ajshe Metaj - Kur flitet për fëmijët model kemi Kuvendin e Kosovës edhe fëmijët e kanë asamblenë e tyre, ju kisha bërë pyetje a është e nevojshme që në komunën tonë të formohet asambleja e tyre? A është e nevojshme me bërë këtë, a ka funksionu më herët?

Kryetari - Nuk më kujtohet që e kemi pasur një asamble të fëmijëve, ndoshta më herët ka pasur por si kryetar nuk më kujtohet diçka. Fëmijët mendoj se duhet trajtuar ndryshe, unë i vizitoj nxënësit dhe i thërras në zyrën time, ju dha ndonjë çokollatë, mendoj se duhet të thirrën në forma tjera, të

vijnë në komunë të shohin si funksionon komuna dhe të marrin disa shpjegime, nuk mendoj se duhet të bëhet asambleja e fëmijëve.

Ajshe Metaj - Në mesin e të gjitha tjerave e kisha selektu abuzimin më fëmijë, që është çështje aktuale tani dhe kisha dashtë më shumë të merremi më këtë dhe t'i kushtojmë rëndësi, unë jam që të punojmë që të parandalohen këto sepse kjo është më të vërtet e keqe për të gjithë.

Kryetari - Problemi është më shumë qysh me ngrit vetëdijen në familje dhe në shoqëri në tërësi dhe gjërat të jenë më transparentë, institucionet duhet më shumë të punojnë në këtë drejtim.

Zenel Shatri - Për mua është brengosëse jo vetëm dhunimi por edhe përdorim i drogave, po flas se kam vërejt gjëra të tilla sepse punoj në spitalin rajonal dhe po shohë raste të shumta që vijnë atje, kjo çështje prek edhe Drejtorin e Drejtoratit të Arsimit, kujdestarët e ditës të kontrollojnë se ka shkojnë fëmijët të jenë më aktiv, në Pejë ka shumë raste të tilla, ky është një apel edhe për drejtorinë që ti kushtojë më shumë vëmendje kësaj.

Ajshe Metaj - Ish dashtë që nga shkolla fillore të mbahen sesione informuese ngase prej atje po vijnë tek ne.

Muhamet Gusturani - Mendoj se edhe brenda për brenda shkollës duhet të ketë një rregullore, edhe shkolla e ka atë të drejtë të përpilimit të një rregulloreje të brendshme dhe të paktën të lexohet neper klasë, ki rregullore mjaftë por një e brendshme është më mirë.

Hajrush Shoshi - Ne kemi pasur edhe disa raste që i ka ndalur policia, persona të dyshimtë, kështu që vazhdimisht po punohet në këtë drejtim.

Kryetari - Duhet më u angazhu më shumë përmes edukimit, jo vetëm me rregullore.

Ajshe Metaj - Mos do ishte mirë ajo rregullore të hartohet nga profesionistët, nuk e di se ku duhet të drejtohem për hartimin e kësaj rregullore, ne vazhdimisht po mundohemi duke ju dhënë informata edhe në orët e mësimi.

Kryesuesi - Pasi nuk dëshiron dikush tjetër të marr fjalën, kush është që kjo të shkojë në KK për shpallje në diskutim publik?

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF njëzëri rekomandon: Projekt-Rregullorja për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor për fëmijët t'i kalohet KK-së për shqyrtim dhe shpallje në diskutim publik.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 5.

Diskutimet:

Kryesuesi - Po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit

të takimeve të KPF-së dhe KK-së për vitin 2019. Bazuar në ligje, statut dhe rregullore të punës kuvendit parashihet që të njoftohen për hir të efikasitetit të përgatitjes së takimeve. Unë pyes nëse keni diçka për këtë kalendar, pasi që nuk ka diskutime kush është që kjo pikë e rendit të ditës t'i kaloj KK-së për shqyrtim dhe miratim?	
Vendimet:	
Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime tjera, KPF njëzëri rekomandon: Kalandari i takimeve të KPF-së dhe KK-së për vitin 2019 t'i kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Kryesuesi, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë dhe shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.	
Mbledhja përfundoj :	12:00